



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjoni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0082

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 3, nenin 109 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 60 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE Valdrini sh.p.k, kundër / lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali” me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 20/02/2023, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e Valdrini sh.p.k me nr. të protokollit 2023/0082, e datës 13/02/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali”, me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës.

II. Obligohet, autoriteti kontraktues – Kuvendi i Komunës se Prishtinës, që të zbatojë vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-se Psh. nr. 516/22 të datës 25. 11. 2022, si dhe Urdhëresën me nr. 516/22 të datës 21. 12. 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali”, me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1.

III. Shfuqizohet, njoftimi mbi vendimin e datës 27. 01. 2023, i autoritetit kontraktues- Kuvendi i Komunës se Prishtinës.

IV. Shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumës 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 25. 11. 2022, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Lartësia e shumës së caktuar transferohet në xhironlogarinë e OSHP-së 1000430070005756 brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK (menaxherit të prokurimit), sipas dispozitës së nenit 25, paragrafi 8, të LPP.

VI. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform neni 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej

gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 29.09.2022, Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali” me nr. të prokurimit: 616-22-5630-5-1 -1.

Me 06.10.2022 OE “Valdrini SH.P.K” Drenas ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 516/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

OSHP ka shqyrtuar ankesën e OE ankues, dhe ka marrë vendim që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe të anulohet njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës, duke kthyer lëndën në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues KK Prishtinë ka bërë rivlerësimin e aktivitetit në fjalë të prokurimit, dhe me datën 27. 01. 2023, ka publikuar njoftimin B58 ku ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik që është konstatuar si i papërgjegjshëm sipas vendimit të panelit shqyrtues PSH. nr. 516/22 të datës 25. 11. 2022.

OSHP me datën 13. 02. 2023, ka pranuar në sistemin e e-prokurimit ankesën e operatorit ekonomik “Valdrini shpk” me numër 82/23 (nr. protokolli), e cila është e jashtëafatshme, për faktin se Njoftimi B58 (njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së) është publikuar me datën 27. 01. 2023. Kërkesa për rishqyrtim e OE “Valdrini” është bërë me datën 30. 01. 2023. AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik me datën 30. 01. 2023. OSHP konstaton se ankesa e OE ankues si afat të fundit për tu dorëzuar në OSHP ka pasur datën 09 shkurt 2023 dhe jo me datën 13 shkurt 2023, dhe e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor konform nenit 108/A dhe 109 të LPP-se.

OSHP, pas verifikimit të zhvillimit të procedurës së prokurimit në sistemin e e-prokurimit konstaton se AK- KK Prishtinë nuk ka zbatuar vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së Psh. nr. 516/22 të datës 25. 11. 2022 si dhe Urdhëresën e datës 21. 12. 2022, andaj OSHP obligon autoritetin kontraktues që të shfuqizoj vendimin B58 të datës 27. 01. 2023 për shkak të mos zbatimit të vendimit të lartcituuar.

Në pajtim me në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i lëshohet gjoba AK- KK Prishtinë, në shumën prej 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 25.11.2022 si dhe Urdhëresës së datës 21. 12. 2022.

Poashtu, paneli shqyrtues në pajtim me kompetencat sipas nenit 105 të LPP-së inicon procedurën për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK- KK Prishtinë (menaxherit të prokurimit), konform dispozitës së nenit 25, paragrafi 8 të LPP.

Në rastin konkret, është jokontetuese se AK nuk ka vepruar në harmoni me Vendimin e cituar, i cili në kuptim të legjislacionit nënkupton aktin administrativ të një organi kompetent, me efekt detyrues për të gjitha palët meqë i njëjti buron nga normat kogente të LPP dhe kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ i administratës shtetërore në shkallë të dytë, andaj veprimi i AK-së e detyron panelin shqyrtues që të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme të cilat i ka të parapara dhe të lejuara me ligjin për prokurim publik.



Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
- OE - Valdrini sh.p.k
- Arkivës së OSHP-së: